

## **GJYKATA THEMELORE NE MITROVICË**

**P nr. 42/14**

**PP.I. nr. 103/2013**

**12 shkurt 2015**

### **NE EMËR TE POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, në trupin gjykues të përbërë prej Gjyqtares së EULEX-it Franciska Fiser, duke vepruar si kryetare e trupit gjykues, gjyqtari i EULEX-it Nuno Manuel Ferreira De Madureira dhe gjyqtari i EULEX-it Paulo Duarte De Mesquita Teixeira, me zyrtaren ligjore të EULEX-it Jana Božović si zyrtare raportuese në lëndën penale kundër:

**Đ. K., emri i babait H. , emri i vajzërisë së nënës H. S., i lindur më                      në                      , me vendbanim në                      në                      pa numër, me kombësi                      , qytetar i Republikës së Kosovës, i martuar,                      me profesion, i punësuar si                      , me gjendje ekonomike mesatare, në paraburgim nga data 3 qershor 2013;**

#### **I akuzuar për:**

*Pika 1 Keqpërdorim seksual i personave nen moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi (1), në lidhje me paragrafin (5), nën paragrafi (3) i Kodit Penal të Kosovës (KPK);*

*Pika 2 Mundësimi i prostitucionit, në kundërshtim me nenin 201, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (1) dhe nenin 20 të KPK;*

*Pika 3 Sulm seksual, në kundërshtim me nenin 195, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (1) të KPK;*

*Pika 4 Keqpërdorim seksual i personave nen moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, në kundërshtim të nenit 198, paragrafi (1) në lidhje me paragrafin (5), nën paragrafi (3) dhe (4) të KPK;*

*Pika 5 Dhunim, në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (2), nën paragrafi (2) i KPK;*

*Pika 6 Dhunim, në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (3), nën paragrafi (4) të KPK;*

*Pika 7 Sulm seksual*, në kundërshtim me nenin 195, paragrafi (2), nën paragrafi (2) dhe (3) në lidhje me nenin 20 të KPK;

*Pika 8 Dhunim*, në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (2), nën paragrafi (3) i KPK; dhe

*Pika 9 Ndihma apo detyrimi i prostitucionit*, në kundërshtim me nenin 241, paragrafi (3) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës;

*Pas mbajtjes së seancës kryesore, të mbyllur për publikun më datat 15, 16, 17 dhe 20 tetor 2014, më datën 10 nëntor 2014, më 2, 8 dhe 9 dhjetor 2014, më 27 dhe 28 janar 2015, më 11 shkurt 2015, në prani të pandehurit Đ. K. , avokatëve të tij mbrojtës Kapllan Baruti dhe Habib Hashani, prokurori i EULEX-it Lili Oprea Steluta, përfaqësuesi i palëve të dëmtuara Burhan Maxhuni, bazuar në aktvendimin (sipas) kërkesës së prokurorisë për masa mbrojtëse të datës 8 shtator 2014 gjatë dëshimit të dëshmitarit të palëve të dëmtuara: A. F. më 16 tetor dhe 8 dhjetor 2014, N. T. më 17 tetor dhe 8 dhjetor 2014, A. L. më 20 tetor dhe 8 dhjetor 2014, S. N. më 10 nëntor dhe 9 dhjetor 2014 dhe dëshmitarët: H. P. më 17 tetor dhe 8 dhjetor 2014, R. A. 20 tetor dhe 8 dhjetor 2014 dhe B. F. më 2 dhjetor 2014 i pandehuri ishte larguar nga gjykatorja.*

*Pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykues të mbajtur më 11 shkurt 2015;*

*Sipas neneve 359 dhe 366 të Kodit të Procedurës penale të Kosovës (tash e tutje: KPP) më 12 shkurt 2015 shpall në mënyrë publike në prani të akuzuarit, avokatëve të tij mbrojtës dhe prokurorit të EULEX-it:*

*Si në vijim:*

## **A K T G J Y K I M**

**I.**

### Sipas pikës 1

**Đ. K.** shpallet **FAJTOR** sepse:

Është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm që i pandehuri në datat e panjohura ndërmjet dhe , në shtëpinë e tij që gjendet në , duke e ditur moshën e saj, kishte më tepër se një herë marrëdhënie seksuale me S. N. E lindur më .

PRANDAJ, **Đ. K. DENOHET** për kryerje të veprës penale të keqpërdorimit seksual të personave nën moshën 16 vjeçare , në kundërshtim me nenin 198, paragrafi (1) të KPK, me anë të kësaj duke *ri-kualifikuar* akuzën fillestare të Keqpërdorimit seksual të personave nën moshën 16 vjeçare, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi (1) në lidhje me paragrafin (5), nën paragrafi (3) i KPK.

### Sipas pikës 2

**Đ. K.** shpallet **FAJTOR** sepse:

Është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm, që i pandehuri në datat e panjohura ndërmjet dhe në shtëpinë e tij që ndodhet në , i propozoi S.N., e lindur më të ketë marrëdhënie seksuale me persona të panjohur, ndërmjet të tjerëve stafit tjetër të , vëllait të tij dhe një personi serb, për një shumë prej 50 Euro e cila shumë do të ndahej në pjesë të barabarta ndërmjet të pandehurit dhe palës së dëmtuar S. N. , por pala e dëmtuar refuzoi të bëj këtë.

PRANDAJ, **Đ. K.** është **DENUAR** për kryerje të veprës penale të mundësimit të prostitucionit, në kundërshtim me nenin 201, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (1) dhe nenin 20 të KPK.

### Sipas pikës 3

**Đ. K.** është shpallur **JO FAJTOR** sepse:

Nuk është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm, që në datën dhe kohën e panjohur në \_\_\_\_\_ të vitit \_\_\_\_\_, në veturën e tij “\_\_\_\_\_”, i pandehuri e ka prekur me qëllim seksual të miturën S.T., e cila ishte 15 vjeçare, në këtë mënyrë: përderisa i pandehuri ishte duke vozitur veturën, e mitura ishte ulur në ulësen e bashkudhëtarit, ndërsa pala e dëmtuar S. N. Ishte ulur në karrigen e pasme. I pandehuri filloi të ledhatoj me qëllim seksual palën e dëmtuar S. T. Në këmbën e saj të majtë.

NE LIDHJE ME KËTË, **Đ. K. LIROHET** nga kryerja e veprës penale të sulmit seksual, në kundërshtim me nenin 195, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (1) të KPK.

#### Sipas pikës 4

**Đ. K.** është shpallur **JO FAJTOR** sepse:

Nuk është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm që më \_\_\_\_\_ në orët e mëngjesit në vendin e njëjtë sikurse nën pikën 1 të dispozitivit, i pandehuri e detyroi palën e dëmtuar ndër moshën 16 vjeçe të ketë marrëdhënie seksuale dhe me qëllim i shkaktoi asaj dehe me alkool personit nën moshën 16 vjeçe – palës së dëmtuar – të miturës S.T. e cila ishte 15 vjeçare me qëllim të thyerjes së rezistencës së saj dhe duke i treguar asaj armë të zjarrit, revole të markës së panjohur dhe kalibër të cilën ai e mbajti në dollap dhe ai e incizoi marrëdhënien seksuale me video kamerë.

NE LIDHJE ME KËTË, **Đ. K. LIROHET** nga kryerja e veprës penale të marrëdhënies seksuale ndër moshën 16 vjeçe, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi (1) në lidhje me paragrafin (5) nën paragrafi (3) dhe (4) të KPK.

#### Sipas pikës 5

**Đ. K.** shpallet **JO FAJTOR** sepse:

Nuk është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm, që në datën dhe kohën e panjohur në vitin deri në \_\_\_\_\_ në vendin sikurse në pikën I të dispozitivit detyroi palën e dëmtuar S.T. të moshës 16 vjeçe të ketë marrëdhënie seksuale pa pëlqimin e saj. duke e ditur që ajo është 16 vjeçe, i pandehuri kërkoi që ajo të ketë marrëdhënie seksuale me atë dhe kur pala e dëmtuar, e e mitura S. T. Refuzoi, i pandehuri me qëllim i shkaktoi asaj dehje me alkool me qëllim të thyerjes së rezistencës së saj dhe duke i treguar asaj armën e zjarrit, revolen të markës dhe kalibrit të panjohur duke i thënë asaj: “Askush nuk mundet të më bëj mua asgjë, as \_\_\_\_\_ e as policia sepse unë i kam të gjithë nga ata në xhepin tim” dhe në këtë mënyrë, ia doli të frikësoj palën e dëmtuar S. T., duke e detyruar atë të ketë marrëdhënie seksuale me atë pa dëshirën e saj, për shkak të kësaj kur pala e dëmtuar S.T shkoi në shtëpinë e saj ai tentoi të bëj vetëvrasje duke gëlltitur barna qetësuese dhe domestos dhe si rezultat ajo ishte shtrirë në spital”.

NE LIDHJE ME KËTË, **Đ. K. LIROHET** nga kryerja e veprës penale të dhunimit, në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (2) nën paragrafi (2) të KPK.

#### Sipas pikës 6

**Đ. K.** shpallet **JO FAJTOR** sepse:

Nuk është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm që në pranverë të vitit \_\_\_\_\_ rreth orës \_\_\_\_\_ në shtëpi të tij në anën \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_ që gjendet në \_\_\_\_\_ i pandehuri e detyroi palën e dëmtuar N. T. të ketë marrëdhënie seksuale me atë pa pëlqimin e saj, duke e dehur ate me disa substanca të dyshuara, në mënyrë që ai bëri më parë një marrëveshje gojore për një shumë prej 20 eurove kështu që ajo do të fshinte shtëpinë e saj e cila gjendet në veri kështu që i pandehuri e mori atë në shtëpi të tij dhe fillimisht ai i përgatit një kafe dhe pala e dëmtuar e cila në momentin që filloi të pinte atë u ndie me marramendje dhe pastaj e humbi vetëdijen dhe i pandehuri duke e shfrytëzuar rastin e gjendjes së saj jo stabile e kreu marrëdhënien seksuale me atë, dhe e regjistroi atë në kamerë.

NE LIDHJE ME KËTË, **Đ. K. LIROHET** nga kryerja e veprës penale të dhunimit, në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (3) nën paragrafi (4) i KPK.

Sipas pikës 7

**Đ. K.** shpallet **FAJTOR** sepse:

Është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm që në fund të \_\_\_\_\_ në një kohë të panjohur në fshatin \_\_\_\_\_ komuna \_\_\_\_\_, i pandehuri i propozoi dhe e mori palën e dëmtuar A. L., e lindur më \_\_\_\_\_, studente, me kombësi shqiptare kosovare, e cila nuk kishte qenë kurrë vetëm në dhe duke vuajtur nga sëmundja e lëkurës – akne në fytyrë të saj, me automjetin e tij tek një specialist i lëkurës, një mjek \_\_\_\_\_ (J. I.) e cila e specifikoi diagnozën dhe terapinë. Pas konsultimit me mjekun, receta ishte marrë nga i pandehuri. Pas kërkimit të barnave në dhe \_\_\_\_\_, në rrugë për në fshatin \_\_\_\_\_, i pandehuri e ndali automjetin pranë një pompe të benzinës dhe kërkoi nga pala e dëmtuara që në shkëmbim të blerjes së barnave, ajo duhet të ketë marrëdhënie seksuale me atë dhe ai filloi të prek atë në gjoks dhe tentoi të puthte atë. Pala e dëmtuar refuzoi këtë dhe filloi të bërtas dhe të qaj, iku nga vetura dhe mendoi të kërcente nga ura.

NE LIDHJE ME KËTË, **Đ. K. DENOHET** për kryerjen e veprës penale të sulmit të tentuar seksual, në kundërshtim me nenin 195, paragrafi (2), nën paragrafi (3) në lidhje me nenin 20 të KPK, në lidhje me *ri-kualifikimin e akuzës* të mëhershme të sulmit të tentuar seksual në kundërshtim me nenin 195, paragrafi (2) nën paragrafët (2) dhe (3) në lidhje me nenin 20 të KPK.

Sipas pikës 8

**Đ. K.** shpallet **FAJTOR** sepse:

Është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm që nga fundi i vitit \_\_\_\_\_ deri më \_\_\_\_\_ në shtëpinë e tij e cila gjendet në \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_, i pandehuri e detyroi palën e dëmtuar A. F. të vazhdoj për të pasur disa herë marrëdhënie seksuale pa pëlqimin e saj në mënyrën, kur ajo i tregoi të pandehurit për të ndalur të bërit e marrëdhënies seksuale me atë, i pandehuri e kërcënoi atë që ai do të tregonte se ajo kishte pasur marrëdhënie seksuale me atë kështu që familja e saj do të zbulonte këtë, ai do të vinte te shtëpia e saj, të turpëronte atë, t'i tregonte vëllezërve të saj rreth lidhjes së tyre.

NE LIDHJE ME KËTË, **Đ. K. DENOHET** për kryerje të veprës penale të dhunimit, në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (1) të KPK, në lidhje me këtë *duke ri-kualifikuar akuzën fillestare* të dhunimit, në kundërshtim të nenit 193, paragrafi (2) nën paragrafi (3) të KPK.

#### Sipas pikës 9

**Đ. K.** shpallet **JO FAJTOR** sepse:

Nuk është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm që në kohën e panjohur prej \_\_\_\_\_ deri më \_\_\_\_\_ në vendin sikurse në pikën e akuzës 1 të dispozitivit me qëllim të përfitimit të paligjshëm financiar për vete, ai iu kërcënuar palës së dëmtuar A. F. të kryej një veprim, kështu fillimisht, pasi që ai i dha palës së dëmtuar herë pas here të holla prej 20 – 50 euro dhe kur pala e dëmtuar i tha atij që se ajo donte të ndalte kontaktin me të, i pandehuri iu kërcënuar seriozisht asaj dhe e detyroi atë të kryej akt seksual me të apo t'i kthej 900 euro, dhe kur pala e dëmtuar i kërkoi asaj t'i jepte asaj dy muaj derisa ajo të gjente një punë, ai i tregon asaj “një natë seks me mua dhe 5 euro do të zbriten nga borxhi”.

NE LIDHJE ME KËTË, **Đ. K. LIROHET** nga kryerja e veprës penale të ndihmës apo detyrimit të prostitucionit në kundërshtim me nenin 241, paragrafi (3) në lidhje me nenin 228, paragrafi (8) të KPRK.

## II.

1. PRANDAJ, sipas dispozitave të nenit 2, nenit 43, paragrafi (1) nën paragrafi (1.2) dhe nenit 45, paragrafët (1) dhe (2) të KPRK, trupi gjykues i cakton dënimet në vijim:
  - **Đ. K.** duke qenë i dënuar për veprën penale të përmendur sipas pikës 1 **DËNOHET** në 5 vjet burg; dhe
  - **Đ.K.** duke qenë i dënuar për veprën penale të përmendur sipas pikës 2 **DËNOHET** në 3 vjet burg; dhe
  - **Đ.K.** duke qenë i dënuar për veprën penale të përmendur sipas pikës 7 **DËNOHET** me 3 vjet burg dhe
  - **Đ.K.** duke qenë i dënuar për veprën penale të përmendur sipas pikës 8 **DËNOHET** në 6 vjet burg.
2. Sipas nenit 80, paragrafi (2) nën paragrafi (2.2) i KPRK trupi gjykues i cakton dënimin **UNIK:**

**Đ. K. DENOHET** me 14 vjet burg.

## III.

Sipas nenit 365, paragrafi (1) nën paragrafi (1.5) të KPP koha e kaluar në paraburgim nga **Đ. K.** nga data 3 qershor 2013 deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit do të llogaritet në kuadër të dënimit.

## IV.



Trupi gjykues **URDHËRON** që automjetet , me ngjyrë të hirit e identifikuar me tabela të regjistrimit dhe , me ngjyrë të kuqe e identifikuar me tabela të regjistrimit , që ishin konfiskuar përkohësisht nga policia duhet t'i kthehen menjëherë pasi që aktgjykimi në këtë rast të bëhet i formës së prerë.

## V.

Sipas nenit 453, paragrafët (1) dhe (2) të KPP **Đ. K.** i paguan shpenzimet e procedurës në shumë prej 300 eurove jo më vonë se 30 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## VI.

Sipas neneve 458, 459, 460 dhe 463, Paragrafët (1) dhe (2) të KPP, paditë pronësore të parashtruara nga dëshmitarët R. A. dhe H. P. refuzohen, palët e dëmtuara S. N., N. T. dhe A. L. udhëzohen që ato mundën të ushtrojnë paditë e tyre pronësore të tyre në procedurë civile.

**MJETI JURIDIK:** I pandehuri, avokati i tij mbrojtës, prokurori apo palët e dëmtuara kanë 15 ditë nga dorëzimi i aktgjykimit të drejtë në ankesën në pajtim me nenet 380 paragrafi (1) dhe 381 paragrafi (1) i KPK. Çdo ankesë duhet të parashtrohet në Gjykatë të Shkallës së parë sipas nenit 388, paragrafi (1) të KPP.

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICË**

**P nr. 42/14**

**12 shkurt 2015**

**Franciska Fiser**

**Nuno de Madureira**

**Paulo Teixeira**

**Kryetare e Trupit Gjykses**

**Anëtar i Trupit Gjykses**

**Anëtar i Trupit Gjykses**

**Jana Božović**

**Procesmbajtës**

E hartuar në Anglishte, si gjuhë e autorizuar.